



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 126/11
prot.

Shkodër, më 12.02.2025

Lënda: Mbi Vendimin Nr. 6, datë 27.01.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz.

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 5.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", Aneksi I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr.22/2018 "Për Strehimin Social", ligj nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", neni 24, neni 54/n, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja "c", dokumentacioni i mbledhjes të këshillit bashkiak bashkëlidhur vendimit u njoh me Vendimin Nr.6, datë 27.01.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz "Për miratim të listës së familjeve përfituese nga subvencionimi i qerave për vitin 2025.

Emrat e përfitueseve (nominalisht) nuk përfshihet në kategorinë e akteve normative për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja "a" e ligjit "Për Prefektin" i ndryshuar, ka detyrim të shprehet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Matilda ANÇONI
Matilda ANÇONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 257 prot.

Fushë-Arrëz, më 30. 01. 2025

VENDIM

Nr. 6, datë 27. 01. 2025

PËR

**"PËR MIRATIMIN E LISTËS TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË
SUBVENCIONIM QIRAJE NË BASHKINË FUSHË-ARRËZ PËR VITIN 2025"**

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ligjin nr.22/2018, "Për Strehimin Social, VKM :362 datë 29.05.2019, "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM Nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr.459 datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësisë të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin", urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 11, datë 07.01.2025 për "Ngritjen e Komisionit të Strehimit për vitin 2025", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, **Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura,

VENDOSI

1. Të miratojë Listën emërore të familjeve që do të përfitojnë subvencionim qiraje për vitin 2025.
2. Të miratojë masën e subvencionit të qirasë me vlerë totale prej **2568450** lekë për periudhën Janar-Dhjetor për vitin 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në vlerën prej **2053050** lekë, dhe në masën 20% nga Bashkia Fushë-Arrëz në vlerën **515400** lekë.

Bashkëlidhur tabela me listën emërore dhe shumat e subvencionimit.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Diasporës, Migracionit, Çështjeve Sociale, dhe Projekteve, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatimeve.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

12 vota pro


0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 30. 01. 2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

